



Periodiku AMF

Në përmbyllje të një viti

Në vitin 2011 u vendos liberalizimi i tregut të MTPL. Ligji i miratuar në Kuvend pati dy ndikime kryesore: rritjen e konkurrencës në tregun e sigurime dhe nxitjen e vëmendjes së AMF për rregullimin dhe mbikëqyrjen e procesit të liberalizimit.

Vijon në faqen 2

AMF dhe pavarësia e rezervuar për të

Pavarësia e rregullatorit financiar nuk është qëllim në vetvete. Pavarësia përbën parim themelor për legjitimitetin dhe besueshmërinë e rregullatorit. Ajo ka rëndësi për të siguruar mirëqeverisjen e rregullatorit, për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e procesit rregullativ e mbikëqyrës dhe për të kontribuar në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare.

Vijon në faqen 3

Vështrim mbi tregjet

Tregu i sigurimeve janar-tetor 2011


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-tetor 2011 arritën shifrën 7,102,537 mijë lekë, përkundrejt 6,795,205 mijë lekë të realizuara në periudhën janar-tetor 2010 ose 4.52% më shumë.

Vijon në faqen 4

Edukimi i konsumatorit

Kriza e tanishme financiare dhe mundësia e përhapjes së saj në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi: Kush duhet të shqetësohet? Informacion teknik

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e USAID-it "Partnerët për stabilitet financiar" (PSF) tetor 2011)



Situata aktuale: Këshilli Evropian për Riskun e Sistemit bën thirrje për veprim të menjëhershëm
"Kriza ka arritur një dimension në nivel të sistemit."

Vijon në faqen 6

Zhvillime të tjera

Mbledhje e Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve në Sigurime (NAIC)

Vijon në faqen 9

Mbledhje të komiteteve të IAIS-it

Vijon në faqen 10

Diskriminimi gjinor në kontratat e sigurimit: Deklaratë e Zv/presidentes së Komisionit Evropian Viviane Reding

Vijon në faqen 11

Konferencë pune me temë "Mbikëqyrja me Bazë Riskun"

Vijon në faqen 12

Aspekte të parimeve ndërkombëtare të IAIS-it

Vijon në faqen 13

Takim mbi çështje të librit të shitjeve dhe infrastruktura e tregut

Vijon në faqen 14

Në këtë numër:

Në përmbyllje të një viti **2**

Vështrim mbi tregjet **4**

Edukimi i konsumatorit **6**

Zhvillime të tjera **9**

Në përmbyllje të një viti

Zhvillimet në tregun financiar jo-bankar, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tij tradicionalisht i kemi përfshirë në prezantimet e raportit vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Këtë vit zgjodhëm të veprojmë ndryshe. Janë një sërë zhvillimesh dhe arritjesh që solli viti 2011 në shumë aspekte, të cilat duam t'i ndajmë me publikun.



Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së

Në vitin 2011 u vendos liberalizimi i tregut të MTPL. Ligji i miratuar në Kuvend pati dy ndikime kryesore: rritjen e konkurrencës në tregun e sigurime dhe nxitjen e vëmendjes së AMF për rregullimin dhe mbikëqyrjen e procesit të liberalizimit. Primet për sigurimin e detyrueshëm motorik deri në tetor 2011 arritën në rreth 3.3 miliardë lekë ose 9.5% më pak se një vit më parë. Kjo ulje i takon kryesisht produktit MTPL e brendshme me rreth 24.5% për primet e shkruara bruto, pavarësisht se numri i kontratave pati një rritje prej 2.1% krahasuar me një vit më parë. Në këtë mjedis të ri me risk relativisht më të lartë, AMF ka vepruar duke hartuar kuadrin përkatës rregullativ dhe sidomos duke theksuar mbikëqyrjen me fokus riskun. Ky hap më çon në evidentimin e një tjetër zhvillimi të rëndësishëm për institucionin e AMF-së, që lidhet me objektivat e afatmesëm të institucionit.

AMF përmbushi objektivin afatmesëm (2009-2011) të mbikëqyrjes efektive si dhe realizoi pjesën më të madhe të objektivit tjetër afatmesëm të sistemit të

menaxhimit të informacionit, i cili ishte i planifikuar për të përfunduar në prill të vitit 2012. Përmbushja e të dy këtyre objektivave ka angazhuar burime të konsiderueshme njerëzore të Autoriteti dhe është mbështetur me përkushtimin e tyre. Të dy objektivat kanë synuar të rrisin efektivitetin dhe cilësinë e procesit të raportimit, analizimit dhe të mbikëqyrjes së tregut financiar jo-bankar dhe operatorëve të tij. Tashmë janë krijuar premiset për të rritur saktësinë dhe shpejtësinë e raportimit dhe për rrjedhojë kjo sjell zhvendosjen gjithnjë e më shumë të burimeve nga raportimi drejt analizës së informacionit. Përveç kësaj hartimi i manualit të inspektimit plotëson kuadrin standardizimit të procesit mbikëqyrës. Në tërësi, përmbushja e të dy objektivave i ka shërbyer synimit të AMF- së për të kaluar drejt mbikëqyrjes më fokus riskun. Në këtë mënyrë synohet të rritet efektiviteti i procesit mbikëqyrës duke mos anashkaluar trajtimin e problematikës së tregut që mbikëqyret. Kjo qasje e re mbikëqyrjeje më çon në nevojën për të theksuar zhvillimin në kuadrin ligjor e rregullativ të AMF-së.

Viti 2011 angazhoi burimet njerëzore të Autoritetin në hartimin e projekt-ligjit për veprimtarinë e sigurimeve dhe të risigurimeve. Hartimi i këtij projekt-ligji ishte i nevojshëm bazuar në zhvillimin e tregut të sigurimeve në vend dhe në procesin mbikëqyrës. Përveç kësaj procesi i integritetit të vendit në BE kërkon që në mënyrë të vazhdueshme ligjet dhe rregullat të sillen në pajtim me direktivat e BE-së dhe kriteret ndërkombëtare të përpiluara për mbikëqyrjen e tregjeve Financiare jo-bankare. Pikërisht këto dy detyra synon të përmbushë projekt-ligji i ri. Projekt-ligji është tashmë në proces diskutimi me grupet e interesit.

Duke përmendur këto zhvillime, më duhet të theksoj se viti 2011 shënoi disa arritje për tregun financiar jo-bankar, por edhe për vetë AMF-në. Në këtë komunikim kam përmendur disa nga zhvillimet më të rëndësishme, por ato nuk janë të vetmet. Komunikimi i vazhdueshëm i AMF-së me publikun i ka sjellë në vëmendje këto zhvillime.

AMF dhe pavarësia e rezervuar për të

Objektivi strategjik në krijimin e AMF-së në vitin 2006 ishte “*krijimi i një institucioni të pavarur de jure dhe de facto*”. Ky objektivi ishte në përputhje, jo vetëm me tendencën e vërejtur gjerësisht në SHBA dhe Evropë, por edhe në tregjet në zhvillim e ekonomitë në tranzicion në dekadat e fundit për zhvendosjen e detyrave të shtetit, nga ato tradicionale tek rregullimi. Ky rregullim realizohet nëpërmjet krijimit të institucioneve rregullatore të pavarura tek të cilat politikanët delegojnë kompetencat e tyre me synimin që politikatat të:

- o Forcojnë besueshmërinë,
- o Zhvillojnë cilësinë,
- o Rrisin efektivitetin,
- o Ruajnë jetëgjatësinë.

Për të njëjtat arsye janë krijuar dhe kanë lulëzuar rregullatorët e pavarur financiarë, që nuk janë gjë tjetër veçse rregullatorë të cilët veprojnë në një sektor të veçantë të ekonomisë. Madje, për shkak të ndjeshmërisë së lartë për çështjet e qëndrueshmërisë financiare, ndjeshmëri e cila sot është shtuar me “*privatizimin e rrezikut*” dhe transferimin e tij tek individët, rregullimi financiar paraqitet më rigoroz dhe më intensiv se në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Pavarësia e rregullatorit financiar nuk është qëllim në vetvete. Pavarësia përbën parim themelor për legjitimitetin dhe besueshmërinë e rregullatorit. Ajo ka rëndësi për të siguruar mirëqeverisjen e rregullatorit, për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e procesit rregullativ e mbikëqyrës dhe për të kontribuar në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Pavarësia e rregullatorit financiar është po aq e rëndësishme për qëndrueshmërinë financiare sa është pavarësia e bankës qendrore për qëndrueshmërinë e politikës monetare.

Debati mbi pavarësinë e rregullatorit është sot në atë fazë që ishte debati mbi pavarësinë e bankave qendrore para më shumë se dy dekadash dhe është nxitur nga kriza financiare.

Në tërësi, pavarësia e autoritetit rregullator financiar përcaktohet si liri për të vepruar. Përkufizimet qartësohen më tej duke e zbërthyer konceptin e pavarësisë në disa përmasa e këndvështrime. Në literaturë dallojmë:

- o pavarësinë nga politika dhe nga industria që rregullon;
- o pavarësinë e objektivit dhe të instrumentit;
- o pavarësinë formale apo de jure dhe atë de facto.

Pavarësia formale ka të bëjë me procesin e delegimit të autoritetit rregullator nga qeveritë tek rregullatorët e pavarur. Ndërsa ajo reale është një faktor vendimtar, plotësues i pavarësisë formale, që ndikon në efektivitetin e procesit rregullativ. Në përgjithësi literatura na njeh dhe me katër përmasa kryesore të pavarësisë: *institucionale, mbikëqyrëse, rregullatore dhe buxhetore*. Vërehet se nuk ka një kufi të prerë midis përmasave të pavarësisë; të njëjtët elementë përdoren për të arsyetuar mbi disa lloje apo përmasa të pavarësisë, madje në disa raste edhe për të arsyetuar mbi përgjegjshmërinë e autoritetit rregullator. Prandaj, për të gjykuar mbi nivelin e pavarësisë së një autoriteti rregullator, çështja shtjellohet në të gjitha këndvështrimet e mundshme, pasi çdo lloj apo përmasë ndikon tek të tjerat duke çuar në forcimin apo dobësimin e krejt pavarësisë. Në përfundim, ajo ç'ka gjykohet dhe vlerësohet bazuar në kuadrin ligjor duhet të ballafaqohet me faktet e zbatimit në praktikë, për të kuptuar nëse në realitet gjejmë zbatim përcaktimet ligjore dhe, nëse jo, sa të shmangura janë ato nga njëra-tjetra.

Nga ballafaqimi i AMF-së me shtjellimin teorik, përgjithësisht, konkludohet se AMF është autoritet, të cilit, me ligj, i është dhënë pavarësi e konsiderueshme.

Vlerësimet më tej tregojnë se nuk mund të themi me bindje se është përmbushur, si qëllimi i ligjit të AMF-së, ashtu dhe objektivi strategjik për krijimin e tij. Kështu, pavarësia e AMF-së, çënohet nga reduktimi i konsiderueshëm i saj në elementët e

pavarësisë financiare dhe të vetorganizimit, si pasojë e veprimit të legjislacionit në lidhje me pagat, shpërblimet dhe strukturën organizative të institucioneve të pavarura, duke minimizuar kompetencat e Bordit të Autoritetit për organizimin e brendshëm të veprimtarisë. Cenimi i pavarësisë në përmasën financiare të tij dobëson pavarësinë e institucionit edhe në përmasat e tjera.

Në përfundim, mund të themi që debati i përgjithshëm mbi rëndësinë që ka pavarësia e rregullatorit financiar, si dhe nevoja për të këmbëngulur që të binden qeveritë dhe politikanët për të respektuar këtë pavarësi, është një debat i vlefshëm edhe për Shqipërinë. Debat i pritët të intensifikohet sa më tepër intensifikohet procesi i integritetit të vendit në BE. Në tërësi, pritët që procesi i integritetit të mbështesë dhe forcojë pavarësinë e rregullatorit financiar.

Është e rëndësishme të rishikohet ligji i AMF-së në frymën e rikthimit të pavarësisë me synim sigurimin e kapaciteteve administrative të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të mirëkualifikuara për t'iu përgjigjur zhvillimeve të tregut që mbikëqyr dhe mbështetjen e një procesi rregullativ e mbikëqyrës efektiv dhe cilësor.

Edhe më e domosdoshme është që ligji të parashikojë mekanizma të cilat do t'a mbronin ushtrimin në mënyrë të pavarur të funksioneve të autoritetit, për ta izoluar nga ndërhyrjet.

Së fundi, rol të vlefshëm në drejtim të forcimit të pavarësisë ka edhe vetë AMF, jo vetëm nëpërmjet përpjekjeve për rritje të cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës e rregullativ, por edhe nëpërmjet angazhimit për edukimin e publikut, industrisë, politikës dhe vetvetes mbi domosdoshmërinë e pavarësisë dhe forcimit të saj.


Vështrim mbi tregjet

Tregu i sigurimeve janar-tetor 2011

<http://amf.gov.al/news.asp?id=605>

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-tetor 2011 arritën shifrën 7,102,537 mijë lekë, përkundrajt 6,795,205 mijë lekë të realizuara në periudhën janar-tetor 2010 ose 4.52% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 54.21% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 45.79 % të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 32.96% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 1.95 % të sigurimeve të Jo-Jetës. 87.51% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 12.25% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.24% u gjenerua nga veprimtaria e risigurimit.


Në janar- tetor 2011 u nënshkruan rreth 1,091,921 kontrata sigurimi, ose rreth 92.54% më shumë se në janar-tetor 2010.



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-tetor (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
Janar-Shtator	2010	2011
A) Sigurim i Jetës	654,199	869,796
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,096,914	6,215,623
a) Sigurimi i Detyrueshëm	3,595,369	3,252,284
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,501,544	2,963,338
C) Risigurimi	44,093	17,117
TOTAL	6,795,205	7,102,537

Volumi i primit të shkruar bruto, janar-tetor 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-tetor 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 45.79 % të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-tetor 2011, arritën 1,899,210 mijë lekë, ose 24.46% më pak se në janar-tetor 2010.

Në janar-tetor 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 994,851 mijë lekë, ose rreth 37.01% më shumë se në janar-tetor 2010.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-

tetor 2011 arritën në 358,224 mijë lekë, apo 0.84% më pak se në janar-tetor të 2010.

Sigurimet vullnetare

Në janar-tetor 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,850,252 mijë lekë, ose 20.33% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 2,963,338 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 33.38 % të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 25.71%, dhe nga sigurimi kasko me 17.67%, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-tetor 2011, arritën në 761,799 mijë lekë, 140.72% më shumë se në janar-tetor 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 89.59% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në janar-tetor 2011 arritën në 869,796 mijë lekë, ose rreth 32.96% më

shumë se në janar-tetor 2010. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal Uniqa Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 32.53% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 48.74% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-tetor 2011 kapi vlerën 1,745,688 mijë lekë, ose 2.62% më pak se në janar-tetor 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara i përket sigurimit motorik me 1,405,324 lekë, apo 80.50% të totalit.

Edukimi i konsumatorit

Kriza e tanishme financiare dhe mundësia e përhapjes së saj në Evropën Juglindore dhe Evropë-Azi: Kush duhet të shqetësohet?

Informacion teknik

www.pfsprogram.org/pfs-technical-brief-4-financial-crisis-and-contagion-who-should-worry
(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e USAID-it "Partnerët për stabilitet financiar" (PSF) tetor 2011)

Situata aktuale: Këshilli Evropian për Riskun e Sistemit bën thirrje për veprim të menjëhershëm "Kriza ka arritur një dimension në nivel të sistemit. Në një njoftim për shtyp, të publikuar pas mbledhjes së këshillit të përgjithshëm të Këshillit Evropian për Riskun e Sistemit, të zhvilluar më 21 shtator, Këshilli është shprehur se:

"Gjatë muajve të fundit, trysnia mbi borxhin qeveritar është zhvendosur nga ekonomitë e vogla, tek disa nga vendet më të mëdha të BE-së. Gjurmët e kësaj trysnie janë të dukshme në shumë tregje evropiane të borxhit qeveritar, ndërsa luajtshmëria e lartë e tregjeve të kapitalit është shenjë se tensionet janë përhapur në të gjitha tregjet e kapitalit në mbarë botën. Situata është rënduar me "tharjen" progresive të tregjeve të financimit me kushte banke. Ndërlidhja e lartë në sistemin financiar të BE-së ka sjellë rrezikun në rritje të vullshme se kjo mund të përhapet ndjeshëm. Kjo vë në rrezik stabilitetin financiar të BE-së në tërësi dhe ka ndikim të padëshirueshëm në ekonominë reale në Evropë dhe më gjerë."

Gjatë tri javëve të fundit, situata ka vazhduar të jetë shumë e vështirë. Kriza ka kapur të gjithë sistemin,

dhe, si e tillë, kërkon ndërhyrje të vendosur: *qeveritë dhe autoritetet kombëtare, si edhe institucionet evropiane, duhet t'i bëjnë ballë krizës dhe të veprojnë me shpejtësi së bashku. Vonesat e mëtejshme vetëm sa kontribuojnë për rëndimin e situatës.*

Deklaratë nga Jean-Claude Trichet, Kryetar i Këshillit Evropian për Riskun e Sistemit, Bruksel, 11 tetor 2011.

Ky material informues teknik, është i katërti në serinë e materialeve që trajtojnë sfidat dhe mundësitë në sektorin financiar të Evropës Juglindore dhe Evro-Azisë, më konkretisht në 12 vendet përfutuese të programit të USAID-it "PARTNERËT PËR STABILITET FINANCIAR". Në këtë material evidentohen ndikimet e mundshme që vijnë nga kriza evropiane e borxhit dhe si mund të preket zhvillimi ekonomik në vendet e Evropës Juglindore dhe në disa pjesë të Evro-Azisë. Në rubrikën e fundit evidentohen llojet e masave të mundshme që është mirë të ndërmarrin vendimmarrësit për politikën dhe donatorët, për të siguruar që sektori financiar të luajë një rol pozitiv dhe të shërbejë si influencë stabilizuese gjatë zhvillimit të ngjarjeve.

1. Përmbledhje e materialit

Kriza evropiane e borxhit nuk është thjesht një shqetësim për Evropën Perëndimore dhe për shumë prej ekonomike të reja në Evropë. Ajo ka sjellë me vete frikën për një dallgë tjetër të krizës financiare globale që filloi në vitin 2008. Kriza e borxhit e ka kapur tashmë rimëkëmbjen në Evropë dhe në Amerikë, sikurse mund të shihet nga treguesit makroekonomikë, siç janë bilanci tregtar dhe kurset e këmbimit valutor, por po aq negative janë edhe efektet afatmesme për bizneset. Firmat e shëndetshme të sektorit privat, në ekonominë reale, janë jetike për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ku përfshihet rritja e sektorit privat, krijimi i vendeve të reja të punës, stabiliteti makroekonomik dhe financiar, politikën e qëndrueshme fiskale dhe ulja e varfërisë.

Sfidat në zhvillim

Shqetësimet për problemet e eurozonës kanë ekzistuar prej fillimit të vitit 2009, kur nëpër titujt kryesorë të gazetave u fol për problemet e Greqisë. Greqia ka hyrë kaq shumë në borxh, sa që nuk ka të ngjarë të jetë në gjendje ta shlyejë të gjithë borxhin e saj. Me vështirësi për gjetjen e financave përballen edhe vende të tjera të eurozonës (si Portugalia, Italia, Irlanda, Spanja) me barra të rënda, por më pak gjymtuese, borxhi. Të gjitha këto vende kanë punuar për të zbatuar reforma dhe masa fiskale që do të sjellin siguri për tregjet, lidhur me aftësinë e tyre për të shmangur rrugën drejtë mosshlyerjes së borxhit. Deri tani, Greqia, Irlanda dhe Portugalia i kanë pranuar huatë shpëtimtare të eurozonës dhe FMN-së, të cilat u ofrojnë kohën e nevojshme për të vënë në zbatim reformat për konsolidimin fiskal.

Bota i ka kthyer sytë nga Evropa, nga e cila kërkohet të zbatohet zgjidhje vendimtare për ta trajtuar këtë problem. Mirëpo, masat e marra deri tani, kanë qenë masa shumë të vogla, të zbatuara tepër vonë. Procesi i vështirë vendimmarrës i Evropës, u dëshmuar kohët e fundit kur Sllovakia e vogël thaujse e nxori nga shinat planin për borxhin në formën e "Fondit evropian për stabilitet financiar", një instrument i rëndësishëm për stabilizimin e sistemit bankar të Evropës, për shkak të shqetësimeve në lidhje me rritjen e riskut për tatimpaguesit sllovakë.

Pasiguritë ekonomike, që lidhen me krizën e borxhit, kanë infektuar edhe sistemin financiar të Evropës. Shumë prej bankave më të mëdha gjith evropiane, të cilat janë aktorë me rëndësi në Evropën Qendrore dhe Lindore, e kanë humbur mundësinë për të përfutuar nga tregjet normale të fondeve. Këtyre bankave do t'u duhet tani të gjejnë kapital të ri privat a publik, për t'i mbrojtur financat e tyre nga risqet që ka sjellë në horizont kriza.

Efekti që ka kriza e borxhit të rritja ekonomike dhe nismat e tjera të USAID-it në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi

Ndërkohë që udhëheqësit evropianë dhe ata botërorë janë duke kërkuar zgjidhje për problemin e borxhit të eurozonës dhe për stabilizimin e bankave më të mëdha evropiane, efekti i krizës të rritja dhe tregjet financiare globale po ndihet në mbarë botën. Ekonomitë dhe sistemet bankare në vendet përfituese të programit të USAID-it “PARTNERËT PËR STABILITET FINANCIAR” në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi janë veçanërisht të zbuluara. Këto vende janë të lidhura ngushtë me Evropën e zhvilluar, përmes tregtisë dhe shërbimeve financiare. Duke qenë se shumica e bankave të rëndësishme për sistemin, në Evropën Juglindore dhe disa syresh në Evro-Azi, janë në pronësi të bankave të Evropës së zhvilluar, në risqet që i kanosen Evropës Juglindore dhe Evro-Azisë përfshihen:

- o Bankat mëmë nga eurozona mund të riorganizojnë ose të marrin vendim për ndërprerjen e operacioneve në tregjet e vogla a jo strategjike;
- o Kërkesat ligjore për bankat që ndodhen në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi, si edhe për bankat mëmë në eurozonë, për gjetjen e kapitalit të ri përkundër mundësisë së kufizuar për të gjetur investitorë të rinj; dhe
- o Bankat mund ta ulin dëshirën për të marrë përsipër risk, në fushën e huadhënies dhe nxjerrjes së produkteve të reja.

Edhe një version i dobët i shqetësimeve të mësipërme ndikon në themelet makroekonomike të një vendi dhe rezultati më i mundshëm do të ishte mosshlyerje e borxhit, e cila do të prekte sektorë të tjerë krahas tregjeve financiare. Për shembull, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nuk do të merrnin dot kredi për kapital qarkullues, ose mund ta kishin të vështirë gjetjen e blerësve për mallrat dhe shërbimet që ofrojnë (për shembull, ngaqë blerësit nuk do të mund të gjenin mjete financiare dhe ngaqë një ekonomi më e dobët e ul kërkesën dhe konsumin). Kjo do të bënte që firmat në gjendje më të dobët të falimentonin. Me rënien e

tregtisë do të tkurrej edhe progresi i arritur në sektorët e bujqësisë (për shembull zhvillimi i partnerëve tregtarë në Evropën Perëndimore). Të gjitha këto rezultate do të kontribuonin në dobësimin e themeleve makroekonomike, duke sjellë rënie të të hyrave tatimore, të cilat do të ndikonin në aftësinë e qeverisë për të dhënë fonde për spitalet, shkollat, ndihmën sociale dhe pensionet, dhe për të investuar në projektet e veprave infrastrukturore për të cilat ka aq shumë nevojë.

Në varësi të drejtimit që do të marrin pasojat e krizës evropiane të borxhit, në ekonomitë e reja të Evropës do të shohim ose (1) një tronditje financiare me pasoja imediate që do të kalonin përmes sistemit financiar dhe mund të marrin pamjen e ngjarjeve që u transmetuan në ekonomitë e reja në vitin 2008 ose (2) një rënie ekonomike të ngadaltë e të zvarritur ose një rimëkëmbje të vonuar.

Asnjë masë a vend i vetëm nuk mund ta zgjidhë barrën e sfidave ekonomike të sotme. Do të jetë e nevojshme marrja e masave vendimtare dhe në kohën e duhur, nga shumë aktorë. Mirëpo, një komponent kyç është të kuptohet që ky nuk është problem vetëm i sektorit financiar, apo problem vetëm i sektorit bankar, apo problem vetëm i një vendi. Ky problem do të ndikojë në të gjithë sektorët ekonomikë, në të gjitha vendet, dhe na përket të gjithëve. Do të duhet që vendet e veçanta të mendojnë për programe të cilat nxisin punësimin, mundësinë për gjetjen e financave, etj. Kjo mund të bëhet në formën e ndërhyrjeve shtetërore, por mund të realizohet edhe përmes nismave të sektorit privat dhe përmes një dialogu që u del përpara problemeve. Kundërpërgjigjet do të ndryshojnë nga vendi në vend, dhe mund të ndikohen nga rruga që do të marrin ngjarjet.

2. Roli i sektorit financiar në rritjen ekonomike

Cilat janë lidhjet ndërmjet rritjes ekonomike dhe një sektori financiar të zhvilluar?



Ngado ekonomistët janë të një mendjeje se sektori financiar luan një rol jetik në mbështetjen e rritjes ekonomike dhe kontributin për uljen e varfërisë.¹ Në ekonomitë e reja, rritja e madhësisë, thellësisë dhe sofistikimit të sektorit financiar sjell rritje më të lartë dhe nivele më të larta të të ardhurave. Përmes ofrimit të kredive, kapitalit dhe shërbimeve të tjera financiare, për bizneset dhe personat që i plotësojnë kushtet për të marrë kredi, sektori financiar mundëson shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve dhe e rrit efikasitetin dhe vëllimin e veprimtarisë në sektorin privat. Një sistem financiar i efektshëm dhe i qëndrueshëm përbën gurin e themelit për një ekonomi tregu, për shkak të rolit që luan në arritjen e stabilitetit makroekonomik, përpunimin dhe bërjen e pagesave dhe ofrimin e mundësive për financa dhe investime.

Në kohë rënieje ekonomike, një sektor financiar i shëndoshë dhe i qëndrueshëm ruan stabilitetin e kreditimit dhe të shërbimeve të tjera financiare. Nga ana tjetër, nëse i lejohet sektorit financiar të zgjerohet me shpejtësi, përtej shërbimeve qendrore financiare (pra përtej huadhënies, ndërmjetësimit të depozitave, përpunimit të pagesave) ai mund të kontribuojë në problemet ekonomike. Një sektor financiar i lënë i lirë, në rritje të vullshme, mund të ushqejë flluska gjatë periudhave me zhvillim ekonomik dhe pastaj mund të bjerë shpejt dhe të ketë humbje gjatë një rënieje ekonomike, duke ndezur kështu vështirësi ekonomike përmes pakësimit të kreditit dhe kapitalit pikërisht atëherë kur këto duhen më shumë. Zvogëlimi i mundësive për të siguruar financa i përkeqëson rëniet ekonomike, me efekte negative afatgjata për perspektivën e zhvillimit të një vendi.

Për shkak të rolit të rëndësishëm që luajnë në ruajtjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme sektorët financiarë, qeveritë në ekonomitë në

zhvillim dhe në vendet e zhvilluara i kushtojnë burime të konsiderueshme punës për të siguruar që ofruesit e shërbimeve financiare të kenë aftësi paguese dhe besimin e publikut. Mbikëqyrja dhe kontrolli i sektorit financiar është detyrë e vështirë e cila bëhet më e vështirë për vendet në zhvillim.

Në përgjigje të krizës globale financiare të ndezur në vitin 2008, udhëheqësit botërorë dhe organet e qeverisjes kanë kërkuar reforma rregullatore dhe strukturore për ta fuqizuar sistemin financiar botëror dhe për të parandaluar ose minimizuar efektin e një krize tjetër financiare. Grupi G-20 ka qenë në krye të përpjekjeve për reformat dhe bashkërendimit të punës që bën Bordi i Stabilitetit Financiar, institucionet financiare ndërkombëtare dhe organet ndërkombëtare të vendosjes së standardeve.

“Nëse nuk arrijmë ta marrin seriozisht sa duhet botën në zhvillim, nëse i shpërfillim pasojat e padëshirueshme, dhe nëse vendosim zgjidhje të njëjtë për të gjithë, atëherë mund të komprometohet puna për krijimin e një sistemi global financiar më të qëndrueshëm...” shprehet Vincenzo La Via, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Botërore dhe Përfaqësues në Bordin e Stabilitetit Financiar.

Zhvillime të tjera

Mbledhje e Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve në Sigurime (NAIC)

<http://www.naic.org/>

Shoqata Kombëtare e Komisionerëve në Sigurime (NAIC) zhvilloi gjatë periudhës 3-6 nëntor 2011, në Maryland, SHBA, mbledhjen e saj të radhës. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, u përfaqësua nga Znj. Elisabeta Gjoni, Kryetrare dhe Znj. Anxhela Dervishi, Drejtore e Analizës e Raportimit. NAIC është një organizatë private, vullnetare, jo fitimprurëse, që ka si anëtarë drejtuesit e autoriteteve rregullatore të SHBA-së. NAIC është krijuar për të nxitur koordinimin, bashkëveprimin

¹ Shih: ADB Economics Working Paper: Financial Sector Development, Economic Growth, and Poverty Reduction: (Material i papërfunduar i ADB Economics: zhvillimi i sektorit financiar, rritja ekonomike dhe ulja e varfërisë): Rishikim i literaturës, 2009

dhe uniformitetin në rregullimin ligjor të sigurimeve, ndërmjet autoriteteve rregullatore të shteteve të ndryshme. Mbledhjet e NAIC zhvillohen rregullisht katër herë në vit, ndërsa komitetet përbërëse mblidhen gjatë vitit periodikisht dhe raportojnë te NAIC gjatë mbledhjeve të tij. NAIC në mbledhjet e tij ndjek një politikë të mbledhjeve të hapura, me qëllim që edhe autoritetet rregullatore të shteteve të ndryshme dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, me fokus në sigurime, të mund të marrin eksperiencë nga tregu amerikan I sigurimeve.

Ndër çështjet kryesore që u diskutuan gjatë miratimit të raporteve nga Komiteti Ekzekutiv dhe grupet e punës të NAIC, përmendim: sistemet e informacionit, çështjet lidhur me aftësinë paguese të grupit, iniciativën për modernizimin e aftësisë paguese, praktikat dhe procedurat e kontabilizimit, mjaftueshmëria e kapitalit, mbajtja e riskut, etj.

Në prezantimin e temave që lidheshin me aftësinë paguese, u theksua që puna e deritanishme ka konsistuar në draftimin e praktikave më të mira për grupet në sigurime e do të vazhdojë me diskutime mbi draftin e manualit për vlerësimin e riskut dhe të aftësisë paguese.

Në mbledhje u trajtuan interpretime të propozuara për parimet ekzistuese të kontabilitetit statutor. Gjithashtu, grupi i punës për mbajtjen e riskut, diskutoi komentet lidhur me pyetjet e intervistës për menaxherët dhe palët e kontraktuara që do të duhet të përdoren gjatë fazës së planifikimit të një inspektimi me bazë risku.

Një prezantim iu kushtua edhe iniciativës së NAIC për modernizimin e aftësisë paguese, e cila konsiston në një vetë shqyrtim të rregullimit ligjor të aftësisë paguese në sigurime, në SHBA dhe përfshin rishikimin e zhvillimeve ndërkombëtare në lidhje me mbikëqyrjen e sigurimeve, të bankave dhe të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit e përdorimit të tyre të mundshëm në kuadrin ligjor të sigurimeve në SHBA.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore.

Mbledhje të komiteteve të IAIS-it

www.iaisweb.org

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) në bashkëpunim me Institutin për Stabilitet Financiar (FSI) dhe Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), zhvilluan gjatë periudhës 8-11 nëntor në Bazel, në zyrat qendrore të BIS, mbledhjet e radhës të komiteteve të IAIS-it. Takimet e Komiteteve të IAIS-it, zhvillohen tre herë në vit.

Qëllimi i zhvillimit të takimit ishte shkëmbimi i pikëpamjeve në rregullimin e sektorit të sigurimeve dhe çështjet e mbikëqyrjes, si dhe diskutime në lidhje me draft dokumentat e hartuara nga komitetet dhe grupet e punës të kësaj organizate përpara mbledhjes vjetore të radhës.

Themeluar në vitin 1994, IAIS është organizata ndërkombëtare që përfaqëson rregullatorë dhe mbikëqyrës të sektorit të sigurimeve nga 140 vende të botës, me qëllim vendosjen dhe unifikimin e standardeve të sigurimit. AMF është anëtare e kësaj organizate që prej vitit 2001. IAIS punon ngushtë me organizma të tjera financiare të vendosjes së standardeve financiare dhe organizata ndërkombëtare, si Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Shoqata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë, me qëllim që të kontribuojë në stabilitetin financiar global.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, u përfaqësua në këtë aktivitet nga Znj. Enkeleda Shehi, Nënkrjetare e AMF-së.

Në takimet e Komitetit të Stabilizimit Financiar (FSC), prezantimet u fokusuan në:

- o Raportin e sekretariatit të IAIS-it mbi situatën aktuale të krizës financiare globale në tregun e sigurimeve;
- o Propozimet mbi përgjigjet e IAIS-it për krizën financiare në sektorin e sigurimeve;

o Metodologjinë alternative për vlerësimin e siguruesve potenciale të G-SIFI (institucionet globale me të rëndësishme financiare).

Në mbledhjet e Komitetit Teknik të IAIS-it, mbas raportit të mbajtur nga Kryetari i Komitetit Teknik dhe raportit të sekretariatit të IAIS-it mbi punën e zhvillimet në Komitetin Teknik, diskutimet u përqendruan në:

o Drejtimin strategjik të projektit Com Frame (Kuadri i përbashkët rregullator i mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve aktive në nivel ndërkombëtar);

o Prezantimin mbi disa opsione për rrugët e mundshme për vendosjen e standardeve, pjesë e Com Frame.

Mbikëqyrja efektive e këtyre grupeve të sigurimeve me aktivitete ndërkombëtare, shikohet nga IAIS si një qasje me mjaft rëndësi, pasi sukcesi i saj do të përforconte sigurimin e stabilitetit financiar të organizatës. Objektivi i përgjithshëm i nismës Com Frame, e cila është planifikuar të përfundojë deri në korrik 2013, është të kontribuojë në stabilitetin e sistemit financiar duke mbyllur boshllëqet në mbikëqyrjen e sigurimeve nëpër botë.

Në ditën e fundit të aktivitetit u zhvillua mbledhja e Komitetit Ekzekutiv (ExCo) të IAIS-it. Z. Peter Braumüller, kryetar i saj, raportoi mbi të rejat dhe zhvillimet që nga konferenca vjetore e mbajtur në Seul, Kore e Jugut. Në vazhdim, çështjet e diskutuara përshtinë:

o Raporti i sekretariatit të IAIS-it mbi koordinimin e çështjeve midis komiteteve, si dhe udhërrëfyese mbi zhvillimet e ardhshme;

o Raporti i Komitetit të Stabilizimit Financiar mbi progresin dhe afatet në Projektin G-SIFI;

o Raporti i Grupit të Mbikëqyrjes së ComFrame (Kuadri i Përbashkët Rregullator i Mbikëqyrjes

së Grupeve të Sigurimeve Aktive), etj

Pjesëmarrja e autoriteteve mbikëqyrëse në këtë takim i shërbeu zhvillimit dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes, shkëmbimit të informacionit apo të pikëpamjeve për zhvillimet e reja të tregut të sigurimeve dhe forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse në këtë sektor të rëndësishëm të sektorit financiar.

Në aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të autoriteteve të ndryshme rregullatore, anëtarë të IAIS-it, vëzhgues të ndryshëm nga industria dhe ekspertë të fushës së sigurimeve.

Diskriminimi gjinor në kontratat e sigurimit: Deklaratë e Zv/presidentes së Komisionit Evropian Viviane Reding

<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=MEMO/11/123&guiLanguage=en>

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e datës 1 mars 2011, publikoi rastin Test-Achats (C-236/09) në lidhje me diskriminimin gjinor në primet e sigurimit. Gjatë komentimit të vendimit, Komisioneria për Drejtësinë e Bashkimit Evropian, Viviane Reding, theksoi, se:

“Barazia gjinore në Bashkimin Evropian, ndodhet në momente të rëndësishme. Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 30 vjet më parë, vendosi që Akti për të Drejtat Civile, i vitit 1964, të ndalonte trajtimin e pabarabartë të personave të siguruar me fondin e pensionit, në bazë të gjinisë.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, më 1 mars 2011, vendosi që primet e ndryshme të sigurimit për femrat dhe meshkujt përbëjnë diskriminim gjinor dhe nuk janë në përputhje me Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore. Shtetet anëtare nuk janë të lejuara ti shmangen këtij parimi në legjislacione e vendeve të tyre.

Ky është një hap i rëndësishëm në sqarimin e të

drejtave themelore të barazisë gjinore sipas ligjit të BE-së. Ky vendim gjithashtu thekson fuqinë dhe rëndësinë e kartës të të Drejtave Themelore. Gjithashtu, vendimi ka vlerë ligjore si traktat i BE-së. Asnjë legjislacion i BE-së nuk mund të miratohet kur bie në kundërshtim me të drejtat dhe parimet e garantuara nga Karta Themelore e të Drejtave.

Në muajin tetor të vitit 2010, Komisioni Evropian publikoi një “listë të plotë” të të drejtave themelore” për të siguruar se të gjithë ligjet e propozuara pajtohen me Kartën e të Drejtave Themelore. Kjo listë siguron që rregullat të jenë të pa kontestueshme. Gjithashtu i është propozuar Këshillit dhe Parlamentit Evropian të bëjë shtesa të ngjashme në lidhje me të Drejtat Themelore, kur bëhen shtesa të ligjit të BE-së. Vendimi i datës 1 mars, konfirmon rëndësinë e kësaj çështjeje. Është e rëndësishme të përmendet, se ulja për siguruesit nuk ishte pjesë e propozimit të nisur nga Komisioni për direktivat e vitit 2004. Ajo ishte vetëm një shtesë e bërë më vonë nga Këshilli. Komisioni Evropian, do të shqyrtojë me kujdes përfshirjen e gjykatës për ligjin e BE-së në qasje të barabartë të të mirave dhe shërbimeve për gratë dhe burrat, si edhe për sektorin e sigurimeve dhe konsumatorëve.

Natyrisht që industria e sigurimeve do të jetë e prekur nga ky vendim. Aktualisht, 27 shtete të Bashkimit Evropian lejojnë siguruesit ta përdorin seksin si një faktor matës të rrezikut, për produkte si sigurimi i jetës dhe pensionet vjetore.

Pjesë të industrisë së sigurimeve kanë filluar të lëvizin në drejtim të barazisë gjinore. Tashmë siguruesit janë bërë më fleksibël. Në Belgjikë, Bullgari, Qipro, Estoni, Letoni, Lituani, Holandë dhe Slloveni aplikohen prime të njëjta për të dyja sekset në sigurimet e makinave.

Duke marrë parasysh vendimin, siguruesit përtej Bashkimit Evropian duhet të ndjekin këtë shembull në lidhje me të gjitha kontratat e sigurimit. Në muajt e ardhshëm do të caktohet një takim më liderët e biznesit të industrisë së sigurimeve për të

diskutuar përfshirjen e vendimit.

Pas këtij vendimi, është e qartë që kompanitë e sigurimeve nuk duhet të bëjnë dallime midis femrave dhe meshkujve. Gjithashtu do të behet një çështje për praktikën e mira në biznes”.

Konferencë pune me temë “Mbikëqyrja me Bazë Riskun”

<http://pfsprogram.org/risk-based-supervision-workshop>

Në vijim të konkluzioneve të konferencës mbajtur në Ohër me temë “Sfidat në harmonizimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjes kombëtare të sigurimeve me kërkesat rregullatore të BE-së”, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni në bashkëpunim me USAID' PFS, zhvilloi në Shkup, në datat 3-4 Nëntor 2011, Konferencën me temë “Mbikëqyrja me Bazë Riskun”, me fokus kryesor përgatitjen e pjesëmarrësve të pranishëm me njohuritë e nevojshme për zbatimin e një programi mbikëqyrjeje me bazë riskun në Autoritetet e tyre respektive dhe shkëmbimin e eksperiencave midis pjesëmarrësve, të cilët e kishin zbatuar këtë metodologji.

Ndër temat më të rëndësishme që u trajtuan në Konferencë përmendim: i) *Manuali Serb i Mbikëqyrjes me bazë riskun*, ii) *Tregu i Sigurimeve në Hungari, hapat e nevojshme për të adaptuar mbikëqyrjen me fokus riskun, sistemi i vlerësimit të riskut (Risk Assessment System -RAS) iii) procesi dhe kriteret e klasifikimit të shoqërive në varësi të riskut (rating), dhe Dimensionet e Matricës së Riskut zbatuar nga BaFin- Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Gjermani, si dhe iv) Mbikëqyrja me bazë riskun për sigurimin e katastrofave. Secila prej temave të mësipërme ndiqej nga një rast studimor, i cili diskutohej dhe prezantohej nga pjesëmarrësit, paraprakisht të ndarë në grupe pune. Ndër rastet studimore që u analizuan dhe u prezantuan nga pjesëmarrësit përmendim: (i) Rasti studimor lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e Riskut të Përgjithshëm Neto e Riskut të Përbërë dhe ndryshimi i matricës së Riskut në varësi të*

ndryshimeve në profilin e siguruesit dhe informacioneve të reja (sipas matricës së Riskut prezantuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Serbi), (ii) Rast studimor lidhur me identifikimin e atyre raporteve financiare të përshtatshme për tu aplikuar në metodologjinë e mbikëqyrjes me bazë riskun, dhe vlerësimi i Riskut të Përgjithshëm Neto duke marrë në konsideratë dimensionet e matricës së riskut prezantuar nga BaFin, (iii) Rast studimor lidhur me identifikimin e zbatimit të shoqërive të sigurimit në treg në varësi të shtrirjes së aktivitetit të tyre. Temat e rastet studimore u prezantuan nga drejtues të nivelit të lartë të USAID-it, konsulentë të Bankës Botërore, si dhe drejtues të Agjencive/Autoriteteve të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

U identifikuan, kushtet teknike të nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes me bazë risku për sigurimin e katastrofave, si: *kapitali ose rezerva e përshtatshme dedikuar sigurimit të katastrofave; niveli i përshtatshëm i rezervave teknike; produkte të ndërtaura dhe të vlerësuara me metoda aktuariale; si dhe procedurat më të mira për trajtimin e dëmeve (best practices)*. Objekt i këtij prezantimi ishin dhe çështje të lidhura me pajtueshmërinë ligjore si, frekuenca e raportimeve dhe cilësia e të dhënave të raportuara. Sfidat me të cilat përballen Autoritetet mbikëqyrëse lidhen me nivelin aktual të zhvillimit të tregut, kapitalizimin e tyre, si dhe me mungesën e modeleve të përshtatshme të vlerësimit të riskut. Qasja e përdorur në projektin Europa Re, projekt i Bankës Botërore mbi këtë çështje dhe sfidat e tij u pritën gjithashtu me interes të veçantë.

Në këtë konferencë iu kushtua vëmendje e veçantë edhe situatës aktuale në të cilën ndodhen vendet pjesëmarrëse lidhur me zbatimin e Mbikëqyrjes me Bazë Riskun dhe sfidat me të cilat përballen Autoritetet rregullatore në këtë drejtim. U prezantuan në këtë kuadër hapat konkretë të ndërmarrë për zbatimin e Mbikëqyrjes me Bazë Riskun nga AMF, si dhe detyrat kryesore të cilat duhet të përmbushë Autoriteti për zbatimin e plotë të kësaj metodologjie në tregun shqiptar të sigurimeve.

Aspekte të parimeve ndërkombëtare të IAIS-it
http://www.knf.gov.pl/en/About_us/Composition_of_the_PFSa/index.html

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake, zhvilloi në datat 17-18 nëntor 2011, takimin mbi diskutimin e parimeve ndërkombëtare të IAIS-it.

Gjatë seminarit u prezantuan parimet 8, 9, 15, 16, 23 dhe 24. Parimet kanë të bëjnë me:

- o Administrimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme;
- o Shqyrtimin dhe raportimin mbikëqyrës;
- o Investimet;
- o Administrimin e rrezikut për qëllime të aftësisë paguese;
- o Mbikëqyrjen e grupit;
- o Monitorimin makroprudencial dhe mbikëqyrjen e sigurimeve.

Objekti kryesor i prezantimeve kishte të bënte me njohjen e parimit dhe më pas zbatimin e tij në rastin polak. E veçantë e prezantimeve ishte se në to paraqiteshin parimet e rishikuara nga IAIS në tetor të vitit 2011, të cilat përfshijnë zhvillimet në lidhje me krizën financiare botërore të viteve të fundit dhe theksojnë Solvency II.

Çështjet më të rëndësishme të diskutuara janë si në vijim:

- o Rekomandohet të bëhet vlerësimi i zbatimit të parimeve të IAIS-it në kuadër të FSAP si një mënyrë që rrit njohuritë mbi parimet dhe zbatueshmërinë e tyre, nëpërmjet procesit parapërgatitor, proces i cili kërkon angazhim të konsiderueshëm burimesh (njerëzore dhe kohore). Përveç kësaj, vlerësimi është i dobishëm për të forcuar pavarësinë e autoritetit rregullator pasi përpiket të bëjë më të vetëdijshëm politikbërësit mbi këtë çështje.
- o Parimet e rishikuara janë më të ndërlidhura me njëra - tjetrën duke krijuar edhe mbivendosje. Gjithsesi, nga pikëpamja e zbatuesit, vlerësohet

më e përshtatshme formati i ri për shkak të pjesës shpjeguese që përfshihet në të, duke e standardizuar më shumë procesin e zbatimit.

o Mbikëqyrja e grupit është në fazat e para në Poloni për shkak të numrit të kufizuar të operatorëve që i nënshtrohen këtij parimi, pra edhe njohuritë mbeten më tepër teorike. Ajo ç'ka vërehet është se zbatimi i parimit të mbikëqyrjes së grupit konsiderohet nga operatorët si kërkesë që rrit barrën e raportimit dhe për pasojë mund të çojë në ndryshim të strukturës së organizimit të grupit.

o Çështja e apelimit të vendimeve të autoritetit mbikëqyrës në gjykata mbetet problematike për shkak të kohës së konsiderueshme që merrte procesi në të gjithë shkallët e gjyqësorit. Gjithsesi, gjyqësori shqyrtonte vetëm procedurën dhe jo thelbin e çështjes.

o U rekomandua të konsultohemi në mënyrë të vijueshme me standardet e raportimit të përgatitura nga EIOPA për Solvency II. Gjithashtu u theksua kujdesi që duhet bërë për “regjimin e mbështetjes nga grupi”, pasi një regjim i tillë mund të mos funksionojë (siç ndodhi në fakt) gjatë periudhave të krizave që prekin kompaninë mëmë.

Rasti i Polonisë është i vlefshëm pasi shërben për t'u orientuar në procesin e zbatimit të parimeve dhe sidomos me intensifikimin e procesit të integritetit.

Takim mbi çështje të librit të shitjeve dhe infrastruktura e tregut

<http://www.bis.org/fsi/aboutfsi.htm>

<http://www.iosco.org/>

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI)² i Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS)³ në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë, IOSCO zhvilluan në datat 16-18 nëntor, në Madrid, Spanjë, në zyrat qendrore të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të

Letrave me Vlerë (IOSCO)³ takimin mbi çështje të librit të shitjeve dhe infrastruktura e tregut. Takimi u fokusua në trajtimin e çështjeve të tregut dhe riskut të kreditit në librin e shitjeve.

IOSCO është forumi global më kryesor i rregullatorëve të tregut të letrave me vlerë, ai rregullon më shumë se 95% të tregjeve të letrave me vlerë të botës në 115 juridiksione dhe vazhdon të zgjerohet me anëtarë nga mbarë botën. Vetëm në këtë trajnim morën pjesë rreth 60 përfaqësues nga rreth 42 juridiksione të ndryshme, duke përfshirë vendet më të zhvilluara në botë si SHBA, Angli, Gjermani, Finlandë, Hollandë, etj.

Në fjalën përshëndetëse, Z.Greg Tanzer, Sekretar i Përgjithshëm i IOSCO-s dhe Z. Stefan Hohl përfaqësues i BIS prezantuan zhvillimet dhe sfidat e reja në rregullimin e tregut të letrave me vlerë. Z. Tanzer, u ndal veçanërisht në: *misionin që kishte IOSCO si organizatë ndërkombëtare rregullatore, në zhvillimet e reja të tregut, në krizën globale financiare, planet e ardhshme të IOSCO-s, sfidat e ndryshme që hasin rregullatorët në tregje të ndryshme të letrave me vlerë dhe në strategjitë e kësaj organizate për të përballuar sfidat e së ardhmes. Me rëndësi ishte analiza që ai i bëri krizës globale financiare, disa nga shkaqet që sollën atë dhe mësimet që dalin, siç janë: forcimi i mbikëqyrjes së kujdesshme të kapitalit, të likuiditetit dhe menaxhimi i riskut; rritja e transparencës dhe vlerërimet; ndryshimet në rolin dhe përdorimet e normave të kredisë; forcimin e reagimit të autoriteteve për riskun, etj.*

IOSCO ka vlerësuar disa faktorë kyç, të cilët janë edhe faktorët e përcaktuar edhe nga deklaratat e G20-tës në lidhje me përgjigjet rregullatore ndaj krizës, si: *nevoja për rritjen e kujdesit që duhet ti jepet zbatimit të standardeve ndërkombëtare; nevoja që rregullatorët të rrisin vigjilencën në kërkim të risqeve të reja sistematike dhe ndërmarrja e veprimeve për ti zbutur ato; nevoja për një përmirësim të komunikimit dhe bashkëpunimit në nivel global mes rregullatorëve, etj.*

² Financial Stability Institute

³ Bank for International Settlements

⁴ International Organization of Securities Commissions

Në vazhdim ky prezantim u vijua me prezantime të tjera nga përfaqësues të IOSCO-s, në lidhje me parimet e IOSCO-s për produktet e reja dhe zbatimin e tyre, principet mbi infrastrukturën e tregut financiar dhe gjithashtu në lidhje me sfidat dhe zbatimin e MMoU-së. U diskutuan tema mbi mbikëqyrjen e tregjeve të letrave me vlerë duke përfshirë: perspektivën e krizës së fundit financiare dhe reagimi i rregulatorëve ndaj kësaj krize; *derivativët struktura dhe mënyra e funksionimit; produktet e reja financiare dhe vlerësimi sa më i mirë i tyre; rreziqet dhe sfidat me të cilat mund të përballen shërbimet financiare botërore në të ardhmen; rishikime të kuadrit rregullator të riskut të tregut; një punim mbi zbatimin dhe sfidat në tregun e letrave me vlerë në Gjermani; vëzhgim mbi sigurimin dhe perspektivat e industrisë nga Shoqata e Tregjeve Financiare Europiane, AFME, etj.*

Pjesëmarrësit diskutuan mbi sfidat e kohës në tregun e letrave me vlerë me të cilat ata po përballen dhe mënyrën si po e menaxhojnë, me qëllim që të performojnë punën e tyre.

Takimi ishte projektuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregut të letrave me vlerë, të prezantuara këto nëpërmjet punimeve dhe studimit të rasteve të ndryshme nga vende të ndryshme të botës.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të AMF-së i shërbeu shkëmbimit të informacionit apo të pikëpamjeve për zhvillimet e reja të tregut të letrave me vlerë dhe forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes në këtë sektor të rëndësishëm të sektorit financiar.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, D. Kalaja, T. Baleta,
V. Theodhori, A. Dervishi, Dh. Hazbiu,
J. Mele, J. Dengeri, M. Vaska,
R. Eltari, E. Kokona

